



VENDIMET E BORDIT TË FBK-së të DATËS 06.06.2024, Prishtinë

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur më 06.06.2024 në Prishtinë ka vlerësuar lartë përmbylljen me sukses të edicionit 2023/24 të të gjitha garave që organizohen në kuadër të FBK-së dhe për këtë ka falënderuar të gjitha klubet për përkushtimin dhe punën e palodhshme. Gjithashtu Bordi i FBK-së ka falënderuar të gjithë trajnerët, lojtarët, stafin mbështetës, Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport të Kosovës (MKRS), sponsorët, partnerët mediatikë, dhe tifozët për mbështetjen dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm.

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës ndër të tjera:

1. Ka miratuar Raportet e Punës të Komesarëve të Garave në FBK për edicionin 2023/24 dhe të gjitha raportet e tjera të punës, si dhe ato financiare për aktivitetet e mbajtura në periudhën prill-maj.
2. Ka vendosur që të ndaj informatat dhe të fillojë bisedimet me klubet për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare të FIBA-s në të dyja konkurrencat për edicionin 2024/25.
3. Ka vendosur që të krijojë identitetin e ri për Superliga Meshkujt që nga edicioni i ri 2024/25.
4. Ka vendosur që Kuvendi Zgjedhor i FBK-së të mbahet pas përfundimit të Lojërave Olimpikë Paris 2024, si dhe e ka autorizuar Sekretaren e Përgjithshme të fillojë përgatitjet për këtë kuvend.

Në emër të Bordit Ekzekutiv të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Kryetar

Federata e Basketbollit e Kosovës



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

